



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORATI

Nr. 1815/2 Prot.

Tiranë, më 10.07 2024

VENDIM

Nr. 52, datë 10.07 .2024

PËR

**MIRATIMIN E PROCEDURAVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE TË CIKLIT TË PARË
NË PROGRAMET E STUDIMEVE “SHKENCAT E LËVIZJES”, “FUSHAT E
VEPRIMTARISË FIZIKE, TË SHËNDETIT DHE REKREACIONIT” DHE “SHKENCAT E
REHABILITIMIT” PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025**

Mbështetur në Urdhërin e Përbashkët të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar, Nr.112, datë 05.07.2024 “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2024-2025”, Rektorati në mbledhjen e datës 10.07.2024

VENDOSI:

1. Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore brënda datës **06 gusht 2024** shkarkon nga Portali U-Albania listën e aplikantëve në programet përkatëse të studimit të ciklit të parë në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes dhe Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit dhe ia përcjell dy Njësive Kryesore dhe i afishon në mjediset e tyre dhe në Faqen Zyrtare elektronike.
2. Datat e regjistrimit të kandidatëve për konkursin e pranimit në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes, Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit janë **12-15 gusht 2024 nga ora 09:00 deri në 15:30**.
 - (Regjistrimi do të jetë i hapur për Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes deri në orën 11.00 të datës 19 gusht 2024 dhe për Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit deri në orën 11.00 të datës 22 gusht 2024)
3. Dokumentet që duhet të ketë kandidati për regjistrim për konkurset e pranimit do të jenë:
 - 2 fotografi dokumenti 4x6
 - Fotokopje e kartës së identitetit
 - Mandat pagesa e tarifës së konkurimit
 - Kartela mjekësore.

4. Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes brenda datës **15 gusht 2024**, shpall listat e kandidatëve të regjistruar për konkurset e pranimit.
5. Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore në bashkëpunim me Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit brenda datës **19 gusht 2024**, shpall listat e kandidatëve të regjistruar për konkurset e pranimit.
6. Data e zhvillimit të konkursit të pranimit në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes janë **16-19 gusht 2024**.
7. Data e zhvillimit të konkursit të pranimit në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit është **20-22 gusht 2024**.
8. Rregulloret e konkurseve të pranimit, testet praktike, kartela mjekësore gjenden në Faqen Zyrtare të UST-së.
9. Fatura e tarifës së konkurimit publikohet në datën **07 gusht 2024** pas miratimit nga Bordi i Administrimit.
10. Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore brenda **21 gusht 2024** shkarkon nga Portali U-Albania listen e aplikantëve që kanë përzgjedhur programin e studimit pranë *Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit*.
11. Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore brenda datës **24 gusht 2024**, afishon dhe publikon listën e renditjes së aplikantëve të të tre Fakulteteve, duke përdorur si element identifikues vetëm ID e tyre të maturës.
12. Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore në datë **25 gusht 2024**, ngarkon një kopje elektronike të këtyre listave në Portalin U-Albania.
13. Regjistrimi në Raundin e I-rë të kandidatëve fitues në të gjitha programet e studimit të ciklit të parë në UST do të zhvillohet në datat **30 gusht – 13 shtator 2024**, (7 faza 48-orëshe nga ora **08.00 – 16.30**), me datat si vijon:
30-31; 01-02; 03-04; 06-07; 08-09; 10-11; 12-13
14. Kriteret e pranimit, kuotat e pranimit, testet e konkursit së bashku me rregulloren e përkatëse si dhe plani mësimor për ciklin e parë të studimeve, publikohen në Faqen Zyrtare të UST-së dhe Portalin U-albania.

15. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi dhe marrjen e të gjitha masave për zhvillimin e gjithë procedurave të pranimit të studentëve për vitin akademik 2024-2025, Administratori i UST-së, Zv/Rektorët, Dekanatet e Fakulteteve, Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Studentët.
16. Ky Vendim shpallet në Faqen Zyrtare të UST-së.
17. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI
Prof.Dr. Agrom KASA

